

QENDRA

QENDRESA QYTETARE

PLAN STRATEGJIK 2021-2024

PËRMBAJTJA

No.	Çështjet	Faqe
1	**Hyrje**	**3**
2	**Profili i qendrës "Qëndresa Qytetare"**	**4-5**
3	**Drejtimet kryesore të Planit Strategjik**	**6-12**
	3.1 Misioni	**6**
	3.2 Vizioni	**6**
	3.3 Vlerat	**6**
	3.4 Çështjet kritike dhe strategjitë e adresimit të tyre	**6-8**
	3.5 Qëllimet, objektivat dhe aktivitetet: Programet	**9-12**
	3.6 Qëllimet, objektivat dhe aktivitetet: Menaxhimi organizativ	**13-16**
4.	**Anekset**	
	4.1 Analiza e mjedisit të brendshëm dhe të jashtëm të **qendrës "Qëndresa Qytetare"**	**13**

1. HYRJE

Plani Strategjik 2021-2024 përshkruan drejtimet kryesore të qendrës "Qëndresa Qytetare" për të kontribuar në fuqizimin e rolit të qytetarit në shoqëri, nëpërmjet advokimit të politikave, ndërgjegjësimit qytetar dhe zhvillimit të kapaciteteve të grupeve komunitare për një qeverisje të mirë.

Plani Strategjik u hartua nga një grup pune, i përbërë nga anëtarë të qendrës "Qëndresa Qytetare", me asistencën teknike të Qendrës Kombëtare Burimore të Trajnimit dhe Asistencës Teknike (ANTTARC) nëpërmjet komponentit të asistencës teknike të projektit të USAID "Zhvillimi dhe Bashkëpunimi i Përshpejtuar i Shoqërisë Civile".

Procesi i planifikimit strategjik përfshiu trajnimin dhe asistencën teknike të grupit të planifikimit në zhvillimin e misionit, vizionit, analizën e mjedisit të brendshëm dhe të jashtëm të qendrës "Qëndresa Qytetare" , përcaktimin e çështjeve kritike, strategjive të përgjithshme, qëllimeve, objektivave dhe aktiviteteve për programet dhe menaxhimin organizativ të Organizates.

Në tre vitet e ardhshme, qendra "Qëndresa Qytetare" do të fokusojë me prioritet: Lidershipin, qëndrueshmërinë financiare, rritjen e kapaciteteve fizike dhe intelektuale dhe aplikimin e metodave inovative në komunikimin publik.

Plani Strategjik do të shërbejë si një instrument i rëndësishëm për orientimin e Bordit Drejtues dhe të stafit të Organizates në sigurimin e mbështetjes financiare dhe realizimin e veprimtarisë së organizatës.

Drejtor Ekzekutiv

Rigels Xhemollari

2. PROFILI I QËNDRESA QYTETARE

Qendra "Qëndresa Qytetare" (në vijim e quajtuar QQ është organizatë jofitimprurëse, e regjistruar në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë, me vendim Nr.1120, datë 15.09.2016 e cila shtrin veprimtarinë e tij në Shqipëri, kontribuon në fuqizimin e rolit të qytetarit në shoqëri, nëpërmjet advokimit të politikave, ndërgjegjësimit qytetar dhe zhvillimit të kapaciteteve të grupeve komunitare për një qeverisje të mirë.

QQ ka një Bord Drejtues, të përbërë nga 5 anëtarë, i cili është organ vendimarrës. Bordi Drejtues përcakton programin e veprimtarisë së qendrërs, shqyrton çështjet ekonomike, nxjerr norma për rregullimin e veprimtarisë dhe emëron/zgjedh anëtarët e organit mët ë lartë administrativ. Organi më i lartë ekzekutiv është Drejtori Ekzekutiv i cili përfaqëson qendrën me të tretët, zbaton programet dhe detyrat e vendosura nga Bordi Drejtues dhe drejton stafin ekzekutiv.

Mbledhjet e Bordit thirren me kërkesë të Drejtorit Ekzekutiv për të shqyrtuar projektet dhe veprimtarine e organizatës, por asnjëherë më rrallë se 1 herë në 4 muaj. Vendimet merren me 50% +1 të votave. Qendra "Qëndresa Qytetare" është një organizatë pa anëtarësi dhe pa rrjet vullnetarësh, ajo vepron si think tank dhe operon në kuadër të bashkëpunimeve me rrjete, aktivistë dhe struktura komunitare.

Projektet e realizuara vitet e fundit:

Titulli i Projektit: Resistance for Good Governance www.qeverisja.qq.com.al
Mbështetur nga: National Endoëment for Democracy (NED)
Kohëzgjatja: 01 Maj 2020 - Prill 2022

Titulli i Projektit: QytetarIN
Mbështetur nga: Leviz Albania
Kohëzgjatja: 01 Prill 2019 - Shkurt 2021

Titulli i Projektit: Arsimi në Fokus
Mbështetur nga: Olof Palme International Center
Kohëzgjatja: 01 Janar 2019 – Dhjetor 2022

Titulli i Projektit: Open University
Mbështetur nga: Friedrich Ebert Foundation Tirana
Kohëzgjatja: 01 Janar 2020 - Dhjetor 2022

Titulli i Projektit: Citizen in Charge Academy
Mbështetur nga: Ambasada Holandeze ne Tirane
Kohëzgjatja: 01Janar 2021 -31 Dhjetor 2023

Titulli i Projektit: Mos Rri po Duku
Mbështetur nga: Bashkimi Europian
Kohëzgjatja: 01 Mars – 30 Shtator 2021

Titulli i Projektit: Monitorimi i Burimeve Shteterore ne Zgjedhje
Mbështetur nga: : WFD
Kohëzgjatja: 01 Shkurt – 30 Gusht 2021

3. DREJTIMET KRYESORE TË PLANIT STRATEGJIK

3.1 Vizioni

Vizioni i jashtëm

Qytetarë të fortë, të aftë për të reaguar dhe fituar të drejtat e tyre.

Vizioni i brendshëm

Qëndresa Qytetare një organizatë me kapacitete dhe fuqi organizative për të monitoruar dhe advokuar mbi politikat publike në nivel qëndror dhe vendor.

3.2 Misioni

Misioni i Qëndresës Qytetare është fuqizimi i rolit të qytetarit në shoqëri nëpërmjet advokimit të politikave, ndërgjegjësimit dhe pjesëmarrjes qytetare dhe zhvillimit të kapaciteteve të grupeve komunitare për një qeverisje të mirë.

3.3 Vlerat e QQ

Qëndresa Qytetare ndan një sërë vlerash të përbashkëta mes anëtarëve të Bordit Drejtues dhe stafit, si më poshtë:

Integriteti

Ne kemi marrëdhënie të hapura dhe transparente me partnerët dhe bashkëpunëtorët.

Kreativiteti

Në punë dhe komunikim ne udhëhiqemi nga qasjet inovative dhe kreative për të arritur qëllimet e organizatës sonë.

Legjitimiteti

Në punën tonë adresojmë problematikat dhe shqetësimet e komuniteteve të cilat përfaqësojmë.

Energjia/Aktivizmi

Ne karakterizohemi nga energjia në grup për të arritur ndryshime në shoqëri në përputhje me misionin tonë.

Bashkëpunimi

Ne bashkëpunojmë me grupe të ndryshme grassroot për të përkthyer nevojat e tyre në nisma konkrete.

3.4 Çështjet kritike/prioritetet dhe strategjitë e përgjithshme

Lidershipi	Që në fillimet e saj, Qëndresa Qytetare është zhvilluar nga një grup të rinjsh të cilët në mënyrë të barabartë kanë përfaqësuar organizatën në përpjekjet e saj. Organizata nuk ka përdorur një individ për të artikuluar qëndrimet e saj apo për tu shfaqur si figurë publike e saj. Secili anëtar ka përfaqësuar organizatën në kauza të ndryshme duke i udhëhequr këto kauza. Për shkak të pozicionimit në protestën studentore, organizata ka në përbërje lidera të rinj me potenciale. Lidershipi i kuptuar në këtë mënyrë është një nga pikat e forta të Qëndresës Qytetare të cilën ne duam ta ruajmë dhe forcojmë. **Strategjitë e përgjithshme përfshijnë:** 1. Përfshirja në organizatë e liderave të rinj që përfaqësojnë kauza të tjera komunitare. 1. Zhvillimi i kapacitetit të liderave të rinj pjesë e Qëndresës Qytetare. (Akademi politike/lidershipi, shkëmbime eksperiencash, mundesi promovimi).
Qëndrueshmëria financiare	Qëndrueshmëria financiare është një nga sfidat e organizatës nëpërmjet së cilës do të sigurojmë vijimësinë e aksionit qytetar, ruajtjen e stafit në periudha afatgjata dhe sigurimin e ambienteve të punës në mënyrë të qëndrueshme. Duke qënë se organizata përfshin në aktivitete dhe bazën e saj një numër të madh të rinjsh, motivimi i tyre për të qënë pjesë aktive në veprimtarinë e Qëndresës mbetet një sfidë. Qëndresa është një organizatë e re dhe si e tillë konkurron në një mjedis organizatash me eksperiencë në sektor. Gjithashtu, mbulimi i kostove të aktiviteteve sociale të Qëndresës jashtë kuadrit të projekteve specifike, me të rinj dhe grupet e përfshira mbetet i vështirë ndërkohë që këto të fundit janë të rëndësishme për të motivuar të rinjtë që punojnë me organizatën. **Strategjitë e përgjithshme përfshijnë:** 1. Diversifikimi i burimeve të të ardhurave - Realizimi i shërbimeve të sondazheve dhe studimeve për të tretë; ofrimi i trajnimeve dhe konsulencave. - Ngritja e një qendre rinore sociale që ofron shërbime për të rinjë dhe komunitetin duke gjeneruar dhe të ardhura. - Përdorimi i aseteve të siguruara nga projektet nëpërmjet kontratave të qerasë. - Krijimi dhe përshtatja e opsionit fundraising në faqen zyrtare.

2. Diversifikimi i bazës së donatorëve.
- Marrëveshjet afatagjata me donatorët e qëndrueshëm.
- Përditësimi i një databaze me informacion të plotë mbi donatorët aktivë në fushat prioritare të organizatës.
- Aplikimi i vazhdueshëm në thirrjet me interes në donatorë të ndryshëm.

Aftësia e limituar në shkrimin e projekteve

Meqënëse organizata është e re dhe nuk ka eksperiencë të gjatë në shkrimin e projekteve, kjo përbën një sfidë që duhet adresuar. Aplikimi në grante të donatorëve ndërkombëtarë si Bashkimi Europian, përvec kriterit të eksperiencës kërkon dhe aftësi profesionale në shkrimin e projekteve. Për shkak se organizatat vendase i shohin këto projekte si burime kryesore të ardhurash, konkurrenca për një numër të limituar grantesh është e madhe. Pas pranimit të statusit kandidat dhe hapjes formale të negociatave vihet re një tendencë në rritje për thirrje për aplikime për organizata të shoqërisë civile në lëmin e integrimit europian, gjë me të cilën duhet të përshtatet edhe Qëndresa. Me këto zhvillime nevoja për shkrimin dhe aplikimin në këto projekte rritet.

Strategjitë e përgjithshme përfshijnë:
1. Sigurimi i trajnimeve periodike për stafin mbi shkrimin e projekteve të Bashkimit Europian.
2. Forcimi i menaxhimit financiar të organizatës.
3. Rrjetëzim dhe partneritet me organizata më të zhvilluara vendase për të shkruar projekte të përbashkëta.
4. Pjesëmarrje në planifikim dhe zbatim projektesh me organizata nga vendet e BE dhe Rajonit me fokus fuqizimin e qytetarit.

Aplikimi i metodave inovative në komunikimin publik

Sipas një sondazhi të zhvilluar nga organizata, rezulton se të pkatën 50% e të rinjve momentalisht njihen me çështje dhe problematika sociale/politike nëpërmjet instagramit dhe facebookut. Organizata duhet të adaptohet që të arrijë këto audienca. Aktualisht organizata ka nisur përdorimin e spoteve, infographics, deklaratave për mediat të ndërthurura me imazhe dhe aksioneve kreative për të arritur vëmendjen e grupeve të synuar. Për shkak të rritjes në vazhdim të përdorimit të rrjeteteve sociale nga të rinjtë dhe qytetarët për tu informuar dhe përfshirë, lind nevoja e thellimit të qasjes inovative ne komunikimin publik.

Strategjitë e përgjithshme përfshijnë:

1. Rritja e kapacitetit të stafit në përdorimin e metodave inovative në komunikim.
2. Zhvillimi i një strategjie komunikimi publik për organizatën.
   - Angazhimi aktiv në kanalet e medias sociale për të ndarë aktivitetet dhe arritjet e organizatës me ndjekësit për të rritur audiencën.
   - Përdorim i facebook ads duke e përfshirë si zë në projektet me donatorë.
   - Rritje e numrit të ndjekësve në facebook page dhe instagramme e organizatës.
3. Zhvillimi i një politike dhe rregullave të brendshme për komunikimin e jashtëm.
4. Rritja e kapaciteteve teknike për përpunim dhe prodhim të materialeve dixhitale si video, infografik dhe spote duke punesuar nje eprson pergjegjes per komunikimin.

3.5 Qëllimet, objektivat dhe aktivitetet: Programet

Programet kryesore të qendrës "Qëndresa Qytetare" do të përfshijnë:

- Advokimi i politikave;
- Ndërgjegjësimi dhe pjesëmarrja qytetare;
- Zhvillim i kapaciteteve të grupeve komunitare.

Qëllimet, objektivat dhe aktivitetet e programeve, paraqiten në tabelat e mëposhtme:

(a) ADVOKIM I POLITIKAVE

Qëllimi: Përmirësimi i legjislacionit dhe politikave publike dhe zbatimit të tyre në funksion të qeverisjes së mirë.

No.	Objektivat specifike	No.	Aktivitetet
1.	Rritja e kapaciteteve të të rinjve në fushën e advokimit si agjentë ndryshimi.	1.1	Monitorim i politikave publike në nivel qendror në cdo ministri nga grupi i të rinjve analistë.
		1.2	Monitorimi i proceseve të politikave publike në fushën e Arsimit dhe organizimi cdo vit i Kongresit Studentor Kombëtar.
		1.3	Ushtrim i peticioneve elektronike dhe i iniciativës ligjvënëse me 20 000 nënshkrime qytetarësh me të drejtë vote për çështje që lidhen me arsimin, të drejtat qytetare dhe qytetin.
		1.4	Hartimi dhe miratimi nga IAL-të publike i Programeve model të transparencës të dedikuar sipas ligjit 80/2015 për Arsimin e Lartë.
		1.5	Trajnimi i vazhdueshëm i të rinjve të angazhuar për monitorimin e politikave publike.
		1.6	Organizimi i debateve dhe analizave publike për të ndarë dhe ballafaquar rezultatet e monitorimit me qytetaret.
2.	Shtrirja e avokimit në nivel vendor në Bashkitë e tjera në vend.	2.1	Facilitimi i ushtrimit të së drejtës së Peticionit dhe Iniciativës Qytetare në Bashkinë Tiranë nëpërmjet aplikacioni Qytetarin.com
		2.2	Forcimi i bashkëpunimit me partnerët e Koalicionit “Lëviz për Tiranën”.
		2.3	Angazhimi në zgjedhjet vendore duke monitoruar kandidatët, burimet shteterore dhe administratën në fushatë dhe duke informuar votuesit për herë të parë.
3.	Zbatim efektiv i legjislacionit ekzistues dhe rritje e rasteve të ndëshkueshmërisë.	3.1	Miratimi i akteve ligjore të propozuara nga Qëndresa Qytetare nga ana e organeve kompetente ligjvënëse dhe ekzekutive.
		3.2	Ofrim i iasistencës ligjore falas për të rinjtë dhe ngritja e Klinikës Ligjore për studentët
		3.3	Denoncimi dhe adresimi i shkeljeve dhe i paligjshmërive në autoritetet përkatëse.

		3.4	Ndarja e gjetjeve dhe eksperiencës me institucionet e pavarura si Avokati i Popullit, Kontrolli i Lartë i Shtetit, Komisioneri për të Drejtën e Informimit.
		3.5	Takime për të prezantuar gjetjet me aktorë ndërkombëtarë.

(b) NDËRGJEGJËSIMI DHE PJESËMARRJA QYTETARE

Qëllimi: Vetëdijësimi i komunitetit mbi hapësirat dhe mundësitë ligjore për të ushtruar të drejtat e tyre dhe për të marrë pjesë në vendimmarrje.

No.	Objektivat specifike	No.	Aktivitetet
1.	Rritja e nivelit të informimit të qytetarëve mbi të drejtat e njeriut.	1.1	Seanca informimi për qytetarët mbi praktikat anti-korrupsion dhe denoncimin e tyre, me anëtarë të policisë dhe prokurorisë.
		1.2	Fushatë vjetore informimi "Java kundër Korrupsionit" si domain i Qëndresës Qytetare.
		1.3	Fushatë informimi për të rinjtë mbi kompetencat e qeverisjes vendore në kuadër të zhvillimit të zgjedhjeve vendore dhe ushtrimin e të drejtës së votës.
		1.4	Prodhimi dhe shpërndarja e materialeve ndërgjegjësuese/informuese online mbi anti korrupsionin, transparencën dhe të drejtat e studentëve.
		1.5	Rritja e ndërgjegjësimit dhe informimit të brezit të ri me krimet dhe pasojat e komunizmit në shoqërinë shqiptare.
2.	Stimulimi i reagimit qytetar nga grupet e interesit.	2.1	Përdorimi i mediave sociale në mënyrë krijuese për të informuar dhe ndërgjegjësuar qytetarët mbi të drejtat e tyre.
		2.2	Organizimi i protestave kreative të gjeneruara nga vetë grupet e interesit dhe studentët.

3.	Rritja e pjesëmarrjes dhe ndikimit të komunitetit në qeverisje.	3.1 Organizimi i interpelancave, konsultimeve publike dhe seancave dëgjimore mes komunitetit dhe Këshillave Bashkiake. 3.2 Forcimin e kapaciteteve të Këshillave Studentore dhe Studentëve përfaqësues në Senat për të propozuar nisma dhe adresuar problematika studentore në organet e universiteteve.

(c) ZHVILLIM I KAPACITETEVE TË GRUPEVE KOMUNITARE

Qëllimi: Grupe komunitare të afta për të reaguar dhe adresuar problematikat e tyre.

No.	Objektivat specifike	No.	Aktivitetet
1.	Rritja e njohurive dhe aftësive të grupeve komunitare kundrejt aktivizmit qytetar.	1.1	Trajnime mbi reagimin qytetar me studentët dhe grupe të tjera komunitare nëpërmjet Akademive të ndryshme.
		1.2	Promovimi i shembujve pozitive (sucess story) të fitimit të të drejtave nëpërmjet ragimit qytetar.
2.	Gjenerimi i nismave konkrete në adresimin e problematikave specifike	2.1	Organizimi i Akademisë së Aktivizmit Kreativ duke e shndërruar në praktikë vjetore dhe gjeneruese të nisamve konkrete nga pjesëmarrësit.
3.	Krijimi i rrjeteve të grupeve me interesa dhe kauza të përbashkëta	3.1	Fuqizim dhe shtimi në numër i pjesëmarrësve në dy rrjetet joformale të krijaura nga Qëndresa Qytetare: - Rrjeti i Studentëve "Arsimi në Fokus" - Albanian Youth for Climate Action

3.6. Menaxhimi i organizatës: Qëllimet, objektivat dhe aktivitetet kryesore

Menaxhimi i organizatës përfshin: Zhvillimi i stafit dhe Bordit Drejtues; Zhvillimi i burimeve financiare; Marrëdhëniet publike; dhe Rrjetet e bashkëpunimit.

ZHVILLIMI I STAFIT DHE KESHILLIT DREJTUES

Qëllimi: Rritja e performancës së stafit ekzekutiv dhe Bordit Drejtues në veprimtarinë e Qëndresës Qytetare.

No.	Objektivat	No.	Aktivitetet kryesore
1.	Plotësimi i QQ me stafin e nevojshëm. Rritja e kapaciteteve të stafit të organizatës në fushat prioritare të aktivitetit të saj.	1.1	Rishikimi i strukturës organizative me synim ndarjen organeve vendimmarrëse nga ato ekzekutive.
		1.2	Plotësimi i strukturës organizative me stafin e nevojshëm sipas nevojave të projekteve.
		1.3	Hartimi i përshkrimeve të punës të stafit ekzekutiv të organizatës/projekteve.
		1.4	Trajnimi i stafit në vazhdimësi sipas nevojave.
		1.5	Promovimi i stafit dhe bashkëpunëtorëve në media dhe kanalet e komunikimit të organizatës.
		1.6	Rekrutim i stafit në bazë të vlerave të përgjithshme të organizatës.
2.	Rritja e rolit të Bordit Drejtues në ngritjen e fondeve dhe marrëdhëniet publike.	2.1	Përmirësimi i rregullores së brendshme të Bordit Drejtues dhe zbatimi i saj nga anëtarët.
		2.2	Mbajtja e rregullt e mbledhjeve të Bordit Drejtues në zbatim të rregullores.
		2.3	Pjesëmarrja e antarëve të Bordit Drejtues në aktivitete ku ka prezencë të donatorëve të mundshëm.
		2.4	Ruajtja e kontakteve me institucionet ndërkombëtare dhe pjesëmarrja në aktivitetet e tyre.

ZHVILLIMI I BURIMEVE FINANCIARE

Qëllimi: Rritja e qendrueshmërisë financiare dhe programatike të Qëndresës Qytetare.

No.	Objektivat	No.	Aktivitetet kryesore
1.	Rritja e të ardhurave për mbështetjen e veprimtarisë së QQ nga donatorë potencial.	1.1	Trajnime të stafit të organizatës në shkrimin e projekteve në përputhje me kërkesat e donatorëve.
		1.2	Ndjekja në vazhdimësi e thirrjeve të donatorëve që mbështesin programet e e QQ dhe pjesëmarrja në seancat e tyre informative.
		1.3	Aplikimi për projekte të përbashkëta me partnerë të tjerë të interesuar.
2.	Rritja e të ardhurave nga aktiviteti ekonomik i QQ.	2.1	Gjenerimi i të ardhurave nga aktivitetet e organizatës (konsulenca, publikime dhe sondazhe për të tretë).
		2.2	Lidhja e kontratve të konsulencës me organizata të interesuara.
		2.3	Sigurimi i të ardhurave nga krijimi i një qendre sociale – rinore e cila ofron shërbime për organizatat rinore dhe të rinjtë me synim gjenerimin e të ardhurave për organziatën.

MARRËDHËNIET PUBLIKE

Qëllimi: Rritja e imazhit të Qëndresës Qytetare për kontributin e saj në përmirësimin e qeverisjes.

No.	Objektivat	No.	Aktivitetet kryesore
1.	Rritja e vizibilitetit të aktiviteteve të realizuara nga QQ.	1.1	Sigurimi i pjesëmarrjes së mediave, përfaqësuesve të grupeve të interesit dhe insitucioneve përgjegjëse në aktivitetet e QQ.
		1.2	Pasqyrimi në median sociale i aktiviteteve dhe arritjeve të organizatës.
		1.3	Pjesëmarrja aktive në fushata, tubime, iniciativa që mbrojnë kauza të komunitetit.
2.	Përditësimi i materialeve promovuese.	2.1	Përgatitja e materialeve promovuese të branduara me logon e QQ (Bluza, dosje, buttons etj).
		2.2	Përditësimi i faqes së internetit qq.com.al me materiale që pasqyrojnë arritjet dhe produktet e organizatës.
		2.3	Përgatitja e materialeve informuese (spote, short – video, infografe) për projektet që realizon QQ.

RRJETET E BASHKËPUNIMIT

Qëllimi: Forcimi dhe zgjerimi i rrjetit të partnerëve kombëtarë dhe ndërkombëtarë.

No.	Objektivat	No.	Aktivitetet kryesore
1.	Ruajtja e marrëdhënieve me rrjetet ekzistuese të bashkëpunëtorëve.	1.1	Komunikimi i vazhdueshëm me partnerët ndërkombëtarë për çështje të qeverisjes së mirë dhe advokimit në nivel qendror dhe vendor.
		1.2	Pjesëmarrja në aktivitetet ndërkombëtare të organizuara në fushën e arsimit dhe rinisë.
		1.3	Promovimi i aktiviteteve/projekteve të zbatuara nga QQ tek bashkëpuntorët ndërkombëtarë nëpërmjet medias sociale.
2.	Zgjerimi i marrëdhënieve me partnerë e bashkëpunëtorë të tjerë.	2.1	Identifikimi i organizatave me të cilat QQ ka interes të bashkëpunojë në të ardhmen.
		2.2	Organizimi i takimeve me organizata të mundshme për shkëmbim të eksperiencave dhe ideve në zhvillimin reciprok të tyre.
		2.3	Pjesëmarrje në aktivitetet reciproke të organizatave bashkëpunëtore.

ANNEX A: Analiza e mjedisit të brendshëm dhe të jashtëm të qendrës Qëndresa Qytetare.

PIKAT E FORTA	PIKAT E DOBËTA
• Komunikimi • Burimet njerëzore • Infrastruktura ne pajisje • Lidershipi • Eksperienca • Bordi aktiv mbështetës • Aplikimi i metodave inovative në komunikimin publik	• Mungesa e një hapësire fizike të përshtatshme për të zhvilluar potencialin e plotë të organizatës • Qëndrueshmëria finaciare • Mungesa e një përsoni përgjegjës për komunikimin publik dhe një plani të mirëfilltë komunikimi.
MUNDËSITË	**KËRCËNIMET/PENGESAT**
• Legjitimiteti në komunitetin ku punojmë. • Raporti i mirë me median. • Koalicione me partnerë kombëtarë dhe ndërkombëtarë. • Grupe jo formale të rinjsh dhe studentësh me interesa të përbashkëta. • Marrëveshje bashkëpunimi me autoritetet e pavarura: KLSH, KDIMP,ILDKPKI, Avokati i Popullit.	• Orientimi i donatorëve. • Mjedisi i jashtëm i paqëndruesheëm dhe i paparashikueshëm. • Legjislacioni problematik për OJF-të. • Kultura e shoqërisë.